



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

---

Numri i lëndës: 2019:296257

Datë: 25.02.2021

Numri i dokumentit: 01543589

**C.nr. 696/2019**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI - Departamenti i Përgjithshëm,** gjyqtari Arben Xheladini, në çështjen kontestimore të paditësit N.N, nga fshati Gernqar, Komuna e Klllokotit, kundër të paditurës Komuna e Klllokotit, e përfaqësuar nga Goran Mariknkoviq sipas autorizimit, me objekt kontesti pagesa e të ardhurave personale, vlera e kontestit 1, 749 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 15.02.2021, jashtë seance, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.** Detyrohet e paditura Komuna e Klllokotit që paditësit N.N, në emër të pagave të pa paguara për periudhen 01.10.2019 deri me 31.08.2020, t'ia kompensoj shumën prej 1, 749 Euro, brenda afatit prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Me datë 24.12.2019, paditësi N.N, ka paraqitur padi kundër të paditës Komuna e Klllokotit, me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagave për periudhen 01.10.2019 deri me 31.08.2020, për shkak se, përkundër që kishte punuar në Shkollën Ekonomike-Teknike në fshatin Gernqar, si profesor lëndëve të makinerisë sipas kontratës së lidhur me kohë të caktuar me datë 04.10.2019, nuk e ka pranuar asnjë pagë. Pretendimet e njëjta i ka përsëritur edhe në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë t'ia aprovoj si të bazuar ashtu që e paditura të detyrohet në kompensimin e shumës prej 1, 749 Euro në emër të pagave të pa paguara për periudhën si në kontratë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor, nuk e ka kontestuar faktin se paditësi ka qenë i punësuar te e paditura e gjithashtu as faktin se paditësi nuk është kompensuar për periudhën sa ka punuar. Tutje, përfaqësuesi i të paditurës ka theksuar se paditësi ka qenë i punësuar sipas konkursit të rregullt në punë, mirëpo, nuk kanë mundur që ta fusin në listën e pagave, andaj edhe kërkesën e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën e kërkuar, nuk e ka kundërshtuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, si provë materiale e ka adminstruar kontraten me numer të protokollit 1956/1 të datës 04.10.2019, dhe nga vlerësimi i saj së bashku me pretendimet e palëve ndërgjyqëse, në bazë të nenit 8 të LPK-ës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Me administrimin e provës materiale, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike: Me kontraten me numer të protokollit 1956/1 të datës 04.10.2019, paditësi N.N kishte themeluar marrëdhënie të punës te e paditura, si profesor i lëndëve mekanike në shkollën “Teknike-Ekonomike” në fshatin Gernqar, me tetë (8) orë mësimore në javë dhe me pagë mujore prej 159 Euro. Marrëdhënia e punës ishte themeluar për kohë të caktuar duke filluar nga data 01.10.2019 deri me 31.08.2020.

Në këtë rast, baza ligjore e paditësit buron nga Ligji i Punës, me të cilin në nenin 55. 1 është përcaktuar: “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”. Ndërsa, në par. 2 përcakton: “Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës”. Ndërsa, detyrimi i pagesës e pagës është përcaktuar par. 6 të të njejtit nen: “Paga, paguhet në afatet e përcaktuara me Kontratë Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ose Kontratën e Punës, më së paku një (1) herë në muaj”.

Duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk e kundërshtoi faktin e ekzistimit të marrëdhënies së punës së paditësit dhe faktin se, paditësi për periudhën prej 01.10.2019 deri me 31.08.2020 ka punuar dhe nuk e ka pranuar asnjë pagë, gjykata nuk u lëshua më shumë në vërtetimin e fakteve që nuk janë kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse andaj, edhe e detyroi të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi sipas nenit 463 të LPK, pasi që asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk i kërkoi.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI**  
**C.nr. 696/2019, datë 15.02.2021**

**Gjyqtari,**

Arben Xheladini

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve, duke llogaritur pas ditës së pranimit të këtij vendimit. Ankesa eventuale dorëzohet përmes kësaj gjykate.